

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim network dhe internet për zyrën qendrore dhe degët e Agrokredit sh.a”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 72400000-4
Sherbime te Internetit**

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,900,000(kater milion e nenteqind mije) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,(i ndryshuar) autoriteti/enti kontraktor Agrokredit sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës duhet te kete te punesuar nje personel teknik prej mesatarisht 5(pese) punonjës të siguruar, të siguruar për 3 mujorin e fundit nga data e hapjes se ofertave me keto kompetenca:

1. Te paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar ne menaxhimin e sherbimeve IT, ITIL ose ekuivalent
2. Të paktën 2 (dy) specialiste të certifikuar nga prodhuesi për zgjidhjet e sigurise ne rrjeta.
3. Të paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar per sigurine kibernetike,
4. Të paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar per virtualizim te dhenash ne nivel te avancuar, nga prodhuesi ose ekuivalent
5. Të paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar per mbrojtje email dhe komunikime

Një punonjës mund të ketë më shumë se një kompetencë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin para dhënjes së kontratës:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST,
- Dëshmitë / Certifikata për specialistët e kërkuar origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin
- Diplomat nga universitetet perkates.
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për tre muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesat janë përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj, duke përfshirë licensat profesionale.

Ky projekt përfshin shërbime konfigurimi, instalimi ndaj është e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar për Menaxhimin e Shërbimeve TIK, me

qellim permbushjen me sukses te objektivave te projektit duke siguruar dhe garantuar në të njëjten kohe Autoritetin Kontraktor per realizimin e kontratës, konkretisht:

1. Te pakten 1 (një) punonjes te certifikuar ne menaxhimin e sherbimeve IT, ITIL ose ekuivalent.

Argumentimi: Plotesimi i kesaj kerkese jep garanci me teper qe Operatori ekonomik garanton ideimin dhe konceptimin e sherbimeve IT te projektit ne menyre te menaxhueshme sipas standardeve nderkombetare te njohura, ne gjithë ciklin e tyre, perfshire ketu dhe sherbimet e mirembajtjes dhe termat e SLA-se.

Një çertifikim per Information Technology Infrastructure Library (ITIL) nuk është një premisë thjesht për një aktivitet suporti në back end, por një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit te suportit ne teknologjine e informacionit dhe komunikimit, që është pjese e qëllimit te projektit të Autoritetit Kontraktor.

2. Të paktën 2 (dy) specialiste të certifikuar nga prodhuesi për zgjidhjet e sigurise ne rrjeta,

Argumentimi:

Kerkesa per te pasur punonjes te certifikuar per siguri ne rrjetat kompjuterike te nje niveli te caktuar eshte e rendesishme per sigurine dhe efikasitetin e rrjetave kompjuterike ne sektorin e punes se AK. Punonjesit e certifikuar per rrjeta kane njohuri te thelluara per identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve te sigurise, duke siguruar mbrojtjen e infrastruktures kritike nga potenciale rreziqe te tilla. Kerkesa eshte hartur ne perputhje me specifikimet teknike ne te cilat parashikohen sherbime te dedikuara mbi sigurine. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë përvijen profesionale për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës

3. Të paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar per sigurine kibernetike nga prodhuesi ose ekuivalent .

Argumentimi:

Kerkesa per te pasur punonjes te certifikuar per sigurine kibernetike ka rol primar ne sigurine dhe efikasitetin e sigurise ne sektorin e punes se AK. Punonjesit e certifikuar per sigurine kane njohuri te thelluara per identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve te sigurise, duke siguruar mbrojtjen e infrastruktures kritike nga potenciale rreziqe te tilla. Kerkesa eshte hartur ne perputhje me specifikimet teknike ne te cilat parashikohen sherbime te dedikuara mbi sigurine kibernetike.

4. Te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me deshmi kualifikimi teknik per sherbimet e instalimit.

Argumentimi:

Punonjesit e pajisur me deshmi kualifikimi teknik sigurojne qe operatori ekonomik te realizoje me sukses sherbimet e ndryshme te konfigurimeve/instalimeve, te parandalojne incidente, te reagoje ne emergjenca dhe te permbush standardet e sigurise dhe cilesise sipas kerkesave teknike te projektit.

5. Të paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar per mbrojtje email dhe komunikime .

Autoriteti Kontraktor perdor sisteme komunikimi dhe email te integruara me sherbime kritike te institucionit dhe me 23 deget ne te gjithë vendin. Per te garantuar sigurine e ketyre komunikimeve eshte e domosdoshme qe operatori ekonomik te kete te pakten nje punonjes te certifikuar ne mbrotjen e email-it dhe komunikimeve .

Ky specialist siguron konfigurimin korrekt te protokolleve te sigurise , mbrojtje ndaj phishing , malware dhe sulmeve te kompromentimit te email-it , si dhe ruajtja e integritetit te komunikimit nder-dege.

2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël 20% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve te realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve te realizuara.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me

sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros minimale në të paktën një vit, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit..

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024, *ku te paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.* Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve:

I - ISO 9001, **sipas standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit** ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë sip (e vlefshme ditën e hapjes së ofertave).

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e mësipërme (Nëse nuk është në gjuhën shqipe, çertifikata duhet të përkthehet e të noterizohet).

II - ISO/IEC 20000-1, **sipas standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit** ose ekuivalente (per menaxhimin e shërbimeve te teknologjise se informacionit) (e vlefshme ditën e hapjes se ofertave).

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e mësipërme (Nëse nuk është në gjuhën shqipe, çertifikata duhet të përkthehet e të noterizohet).

III - ISO 27001, **sipas standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit** (e vlefshme ditën e hapjes se ofertave).

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e mësipërme (Nëse nuk është në gjuhën shqipe, çertifikata duhet të përkthehet e të noterizohet).

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021 (i ndryshuar), secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën e mirembajtjes.

Përmbushja e standartit **ISO 9001** ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Certifikimi **ISO 27001** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet vecanërisht të dhënat personale të klientëve të AK siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe që kanë një rendësi dhe konfidencialitet të lartë të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesit mbi to të jetë i verifikueshem e i kodifikuar. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet e duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të shërbimeve te suportit.

Certifikimi **ISO 20000-1** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zotëron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të

gjithë sistemin në terësi i cili është terësisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware). Ky lloj certifikimi garanton gjithashtu Autoritetin Kontraktor se shërbimet e ofruara gjatë zbatimit të kontratës janë sipas standarteve për menaxhimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrave të AKEP, për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve objekt prokurimi dhe të disponojë autorizim për transmetim të dhënash. Për këtë duhet të paraqitet Autorizimi perkates nga AKEP.

Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

Argumentimi: Kërkesa është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa lidhet ngushtesisht me objektin e prokurimit, ku përfshihet dhe ka një rol të madh transmetimi i të dhënave. Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimin me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për certifikime dhe kualifikime sipas objektit të prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë partneritet me prodhues të sistemeve të mbrojtjes dhe sigurse se rrjetit dhe aplikacioneve, dhe prodhues të sistemeve për mbrojtjen e të dhënave nga rrjedhja dhe përdorimi i paautorizuar.

Për plotësimin e këtij kriteri të paraqiten certifikatat perkatese ose deklarimi në faqen zyrtare të prodhuesve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë hartuar, nga komisioni i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Agrokredit sh.a.